

AKT-THEMELIM DHE STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR SOLE 2024 Sh.p.k.

Neni 1

THEMELIMI I SHOQERISE

Sot me dt.10.02.2024 Une Elton Xhani, i datëlindjes 02.04.1980, me Numer ID I00402051E, lindur në Lekaj, banues në Rrogozhine, madhor me zotësi të plotë për të vepruar dhe Gianni Renzo Zoppellaro, shtetas italian, i datelindjes 25.09.1950, me Numer CA19730LB, banues ne Via Dell'Artigianato 13/B Vicenza., madhor me zotësi të plote për të vepruar: Vendosem te krijojme Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **SOLE 2024 Sh.p.k..**

Aktiviteti baze i kesaj shoqerie rregullohet me ane te ketij Statuti.

Shoqeria vepron ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar), me ligjin 9723 data 03.05.2007, per Qendren Kombetare te Biznesit, (te ndryshuar) e te tjera ligje ne fuqi te legjislacionit shqipetar.

Shoqeria do te kete vulen e saj ku do te shkruhet emeri tregtar dhe nipti.

Neni 2

EMERTIMI

Emertimi tregtar eshte **SOLE 2024 Sh.p.k.**

Neni 3

SELIA

Selia e shoqerise do te jete ne adresen; Kavaje, Rruga Sharre Banesa nr 5. Shoqeria **SOLE 2024 Sh.p.k.** ka te drejte te hape zyra, perfaqesi e filiale ne rrethe te tjera te vendit dhe jashte Shqiperise.

Neni 4

KOHEZGJATJA


Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise **SOLE 2024 Sh.p.k.** eshte pa afat.

Afati mund te caktohet ndryshe, apo te vihet ne likujdim, vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ose te Ortakut te Vetem.

Neni 5

PERGJEGJESITE

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e marra per qellime qe nuk perputhen me ato te percaktuara nga Statuti. Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e marra nga ortakët ne emerit e tij personal ndaj personave te trete.



Neni 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **SOLE 2024 Sh.p.k.** eshte: Agjent i shit-blerjes te pasurive patundshme; Veprimtari investimi ne fushen e Turizmit ; si dhe cdo veprimtari tjeter e lejuar nga ligjet ne fuqi.

Neni 7

KAPITALI I SHOQERISE

Vlera e pergjithshme e kapitalit te rregjistruar si Kapital Themeltar Fillestar i Shoqerise **SOLE 2024 Sh.p.k.** eshte ne vleren 100 000 (njeqindmije leke) me Ortake Themelues:

1. **Elton Xhani**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme = 50 000 leke; qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. **Gianni Renzo Zoppellaro**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme = 50 000 leke; qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 8

TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT

1. Ne rastin e transferimit te kuotave te kapitalit, ortaku qe kerkon te shese kuotat e tij te kapitalit duhet te njoftoje me shkrim administratorin, i cili njofton menjehere Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve per cmimin e shitjes se kuotave nga ortaku qe kerkon ti shese.
2. Cmimi i kuotave, oferte ne shitje duhet te vendoset ne baze te vleres reale te shoqerise ne momentin edhenies se te drejtes. Ortaket e tjera mund ti blejne ne raport me kuotat ekzistuese, duke ruajtur te njejtat raporte me kuotat qe posedon sejcili.
3. Ne qofte se brenda 30 diteve nga komunikimi i ofertes per shitje te kuotave te kapitalit te shoqerise, asnjeri nga ortaket e shoqerise nuk shprehet per blerjen e tyre, atehere, kuotat oferte shitje, mund ti transferohen cdo personi qe kerkon ti bleje.

Neni 9

TRANSFERIMI TEK PJESTARI I FAMILJES

Pjeset e kapitalit jane ligjerisht te transferueshme mes bashkeshorteve, si dhe mes paraardhesve dhe pasardhesve. Transferimi i pjeses se kapitalit mes bashkeshortesh, ne rast ndarjeje pasurie gjithashtu nuk kufizohet.

Neni 10

TRANSFERIMI I KAPITALIT NE RRUGE TRASHEGIMIE OSE FALIMENTIMI

1. Ne rast se nje ortak vdes, trashegimtari ose trashegimtare ne rastin e bashkezoterimit te kuotave me trashegimtare e tij, ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem i bashkezoteruesve te

kuotave, do te jene personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues i te drejtave mbi kuoten e tij, Pavaresisht parashikimeve te ketij Statuti, pasuria e ortakut te vdekur nuk clirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me persona te tjere.

2. Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e, vdekjes ose falimentimit te nje ortaku, pas paraqitjes se provave te kerkuara, administratori mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje rregjistrimin e kuotave ne emer te nje personi tjeter te caktuar prej tij si perfitues i kuotes. Nese personi i mesiperem zgjedh te behet zoterues i kuotes ai njofton shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese ky person zgjedh qe nje person tjeter te rregjistrohet si zoterues i kuotes , ai kalon kuoten ne dobi te personit tjeter.
3. Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku, do te kete te drejta qe gezonte zoteruesi kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesmarrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve deri ne momentin e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 11

FORMA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT

1. Kontrata per transferimin e pjeses se kapitalit duhet te jete ne formen e aktit noterial, dhe, ne rast se pronari i ri nuk eshte ortak i shoqerise, duhet te deklaroje shprehimisht ne kontrate se eshte njohur me Aktin e themelimit te shoqerise dhe Statutin e shoqerise dhe se eshte dakord me to. Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.
2. Administrator, mund te refuzoje rregjistrimin e kalimit te kuotes ne QKB, ne rast se kjo kuote nuk eshte shlyer plotesisht ose ne rast se Administratori, nuk eshte dakord me personin te cilit i kalon kuota.
3. Nese administratori, apo administratoret refuzojne te rregjistrojne kalimin e kuotes, ata njoftojne per mospranimin e personit te cilit i kalon kuota, brenda nje muaji nga dita ne te cilen eshte paraqitur ne shoqeri kerkesa per rregjistrimin e kalimit te kuotes.

Neni 12

ZMADHIMI I KAPITALIT

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te rrise pa kufi kapitalin shoqerise, ne cdo moment, dhe nje ose disa here, me votim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve votues prezent apo perfaqesues sipas ligjit.

Mbas miratimit te pasqyrave financiare te vitit paraardhes, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, vendos per fitimet e realizuara. Asambleja mund te vendose, qe, keto fitime te zmadhojne kapitalin e rregjistruar, te rrise rezervat statutore ose te shperndaje dividend.

Ne asnje rast nuk mund te rritet kapitali i shoqerise, pa mbuluar me pare humbjet e trasheguara ne pasqyrat financiare. Ne te gjitha rastet ndryshimet ne kapital pasqyrohen ne pjeset e ortakeve ne menyre proporcionale qe jane deklaruar.

Neperputhje me nenin 77 teligjit nr. 9901, parase te vendoset shperndaja edividetit, administiatori leshon certifikate te aftesise paguese. Kjo certifikate leshohet , vetem nese pas pagimit te dividendit, aktivet e

N. ...

Halit ...

shoqerise i mbulojne teresisht detyrimet e saj dhe se shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.

Administratori njofton per rregjistrim ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 13

KRIJIMI I REZERVAVE

Mbas miratimit te pasqyrave financiare , Asambleja e Pegjithshme e Ortakeve krijon rezerva statutore. Rrezerva statutore duhet te jete per cdo vit jo me pak se 10% e fitimit vjetor. Kur keto rrezerva te kapin shumen e 10% te kapitalit themeltar mund te mos krijoje me rrezerva.

Neni 14

ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

1. Kapitali themeltar mund te zvogelohet me Vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.
2. Ne cdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufinjte e percaktuar me ligj.
3. Zvogelimi i kapitalit te shoqerise perballohet nga secili ortak ne menyre proporcionale sipas kuotave qe zoterojne, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, mund te vendose zvogelimin e kapitalit te shoqerise brenda limiteve te ligjit , qofte edhe nepermjet ortakut te vetem, apo grupe ortakesh, aktivitetesh te shoqerise apo aksioneve ose kuotave te shoqerine te tjera ne te cilat shoqeria ben pjese.
4. Vendimi per zvogelimin e kapitalit njoftohet per rregjistrim ne Qendren Kombetare te Biznesit, nepermjet Administratorit

Neni 15

PERFAQESIMI I SHOQERISE

1. Asambleja e Pegjithshme e Ortakeve.
2. Administratori.

Neni 16

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Organi vendimor i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **SOLE 2024 Sh.p.k.** eshte Asambleja e Pergjithshme Ortakeve.

Vendimet e saj me shumice pengojne ortaket qe mungojne apo te papajtueshem , pervec rasteve te se drejtes se tyre te kundershimit te ushtruar ne raste, afate apo forma te parashikuara ne ligj.

Gjate kohes qe shoqeria do te kete nje ortak te vetem, te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetem. Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pegjithshme e Ortakeve apo Ortaku i Vetem rregjistrohen ne rregjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Asambleja eshte organi me i larte vendimor i shoqerise i cili , e cila, eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine lidhur me ceshtjet e aktivitetit te shoqerise dhe vendos per:

- ' Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

✓ . /



- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe largimin e administratorit
- Emerimin dhe largimin e likujduesve dhe ekspertit kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per personat e emeruar likujdatore, ekspert, perfaqesues ne gjykate etj.
- Miratimin e bilancit vjetor, ndarjen e fitimit dhe miinyien e ndarjes se humbjeve te shoqerise.
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Riorganizimiin dhe Prishjen e shoqerise.
- Ceshtje te tjera te parashikuara me ligj, te cilat ky statut i ie ne kompetence te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Neni 17

MBLEDHJA E ASAMBLESE DHE VOTIMI

1. Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji 9901 dt. 14.04.2008, ne rastet e parashikuara ne statut dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.
2. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar).
3. Asambleja e pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
4. Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese ose te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 perqind te, asetete te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
5. Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te asetete te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certefikuara.
6. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 e 5 te ketij neni, asamblese se pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikes 6 te ketij neni nuk zbatohen nese blerjet, sipas pikave 4 e 5 te ketij neni, kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perdritshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu. Gjithashtu, keto dispozita nuk zbulohen ne rastin kur shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem.
8. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri ne 5, te ketij neni, asambleja e pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.
9. Vendimet ne mbledhjen e asamblese ose pas konsultimit me shkrim merren nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se tre te katertat e kapitalit themeltar. Ky numer votash mjafton edhe per ndryshimin e statutit te shoqerise.
10. Te gjitha vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, regjistrohen ne proces verbal dhe




administratoret jane pergjegjes per ruajtjen e kopjove te tyre.

Neni 18

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

1. Ortaku ka te drejte te informohet lidhur me administrimin e shoqerise, te njihen me bilancin vjetor dhe te kerkoje me shkrim sqarime te cilat i jep administratori i mbledhjes se asamblese.
2. Secili nga ortaket ka te drejte t'i kerkoje gjykates qe te heqe nga funksioni administratorin i cili ka shkelur ligjin.
3. Secili nga ortaket ka te drejte t'i paraqese me shkrim dy here ne vit administratorit pyetje lidhur me problemet, egzistenca e te cileve ve ne dyshim vazhdimesine e aktivitetit te shoqerise. Lidhur me pergjigjen e administratorit vihen ne dijeni edhe Eksperti Kontabel i Autorizuar.
4. Ne rast se shoqeria nuk ka Ekspert Kontabel te Autorizuar, atehere emertimi i nje eksperti kontabel te autorizuar mund te kerkohet ne rruge gjyqesore nga nje ose disa ortake, pjeset e kapitalit te te cileve perfaqesojne te pakten 5% e kapitalit themeltar.
5. Nje nga disa ortake, pjesa e kapitalit te te cileve se bashku perfaqesojne 5% e kapitalit themeltar, mund te kerkojne ne rruge gjyqesore caktimin e nje ose disa eksperteve te ngarkuar per paraqitjen e nje raporti per nje apo disa veprimtari administrative. Raporti i ekspertit i dorezohet ortakut/ortakeve qe ka bere kerkesen, administratorit, eventualisht eksperteve kontabel te autorizuar, ne qofte se jane emeruar, raporti paraqitet ne mbledhjen e ardhshme te asamblese.
6. Ortaku nuk mund te marre hua nga shoqeria, te miratoje ne emer te shoqerise paradheniet ose te behet garant per detyrimet ndaj personave te trete. Ne rast te kundert veprimi eshte i pavlefshem, kjo vlen edhe per perfaqesuesit ligjore te tij, bashkeshortin si dhe paseardhesit e tij.
7. Ortaku qe eshte person juridik, eshte i detyruar qe menjehere te njoftoje ortaket e tjere lidhur me ndryshimet e statutit ose te perberjes se organeve te shoqerise se tij.
8. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.
9. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Neni 19

ADMINISTRATORET

Shoqeria perfaqesohet nga administratori.

Ne emer te shoqerise firmos administratori i cili bashkengjit emertimin tregtar te shoqerise, emerit embiemerin dhe funksionin e tij.

Neni 20

EMERIMI I ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqerise **SOLE 2024 Sh.p.k.** do te jete nje ose me shume persona qe te emerohen nga Asamblejae Pergjithshme e Ortakeve me shumicen e zakonshme te votave te ortakeve ose Ortakut te

Vetem. Administratori emerohet per nje alat pese vjecar me te drejte perseritje

Administratori i shoqerise do te jete z. Elton Xhani, i datelindjes 02.04.1980, me Numer ID I00402051E, per nje afat 5 vjecar me te drejte perseritje.

Administratori mund te jete ortak ne shoqeri ose jo.

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve mund te shkarkoje ate ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

Neni 21

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ka te drejte te veproje ne emer te shoqerise ne marredhenie me persona te trete persa i perket te gjitha ceshtjeve me perjashtim te atyre qe ligji ose ky statut i le ne kompetence te asamblese.
2. Administratori ka per detyre ne kuadrin e kompetencave te tij te siguroje mbajtjen e rregullt te evidencesdhellogarise sipasligjit, te mbaje listene tegjithe ortakeve dheinformojeortaket lidhur me ceshtjet qe i takojne shoqerise.
3. Pergadit dhe nenshkruan bilancin vjetor dhe raportet per ecurin ti e shoqerise dhe se bashku me propozimet per shperndajen e fitimeve, i paraqet para asamblese se pergjithshme per miratim;
4. Paralajmeron ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise ;
5. Kryen rregjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
6. Raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe ne realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise.
7. Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene e,Pergjithshme ne rastet kur:
 - Sipas bilancit vjetor apo rapoteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivetin e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
 - Kur kerkohet shitja apo disponimi i aktiveve ne nje menyre tjeter me nje vlen me te larte se 5% easeteve te shoqerise te vleresuara ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
8. Administratori ka per detyre te percaktoje stafin drejtues dhe te pajtoje punemarres ne shoqeri ne funksionet qe ai i sheh te aresyeshme .
9. Nenshkruan kontratat e punes me punemarresit.
10. Kryen detyra te tjera te percaktuara ne kete statut.

Neni 22

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori i shoqerise eshte pergjegjes individualisht , ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojat e

marrevshjeve te pamiratuara nga asambleja, qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrevshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

2 Pavec sa Eshite parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17,e 18 te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar)

3 Administratori nuk mund te marre hua nga shoqeria, te miratoje ne emer te shoqerise paradheniet ose te behet garant per detyrimet ndaj personave te trete. Ne rast te kundert veprimi eshte i pavlefshem, kjo vlen edhe per perfaqesuesit e tij ligjore, bashkeshortin si edhe paraardhesit apo paseardhesit e tij.

4 Administratori ka detyre qe te pakten nje here ne vit t'i paraqese asamblese raportin mbi aktivitetin e shoqerise dhe gjendjen e pasurise se tij.

5 Administratori pergatit dhe i paraqet asamblese raportin lidhur me marrevshjen mes atij ose nje ortaku dhe shoqerise. Ortaku qe eshte pale e marrevshjes rink mund te votoje ne mbledhjen e asamblese. Administratori ose ortaku qe nenshkruajne njemarrevshje pamiratimin e asamblese i pergjigjen shoqerise per demin e shkaktuar si pasoje e kesaj marrevshjeje.

6 Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim qe lidhet ne menyre te aresyeshme me qellimet eshoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Neni 23

USHTRIMI VJETOR, PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

1. Viti ushtrimor i aktivitetit te shoqerise mbyllet me daten 31 Dhjetor. Ne fund te vitit ushtrimor administratori procedon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave te ligjit, duke e shoqeruar me nje relacion shtese per aktivitetin e shoqerise.

Neni 24

NDARJA E FITIMIT

Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te ligjit 9901 date 18.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerive tregtare" (i ndryshuar), shoqeria me shumice te kualifikuar te votave te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ose ortakut te vetem te saj, mund te deklaroje shperndarjen e dividenteve ne perputhje me te drejtat perkatese teortakeve.

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor, reduktuar me 5% te destinuar per rezerven ligjore, qe arrin deri ne 10 % te kapitalit te shoqerise, si edhe reduktimet eventuale te percaktuara nga Asambleja, shperndahen ndermjet ortakeve ne raport me kuotat e kapitalit qe zoteron secili.

Neni 25

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Te gjitha mosmarrevshjet qe mund te dalin gjate kohes se ushtrimit te veprimtarise se shoqerise nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidhja e Aktit te Themelimit dhe Statutit te shoqerise si dhe ne pergjithesi te gjitha

mosmarreveshjet e ortakeve, apo midis nje ortaku dhe shoqerise, ne parim do te zgjidhen me mirekuptim ne baze te aktit te Akt-themelimit dhe Statutit, ne mungese te mirekuptimit zgjidhja i besohet Gjykates Shqiptare kompetente ne Rrethin Gjyqesor perkates.

Neni 26

PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Shoqeria shperbehet :

- Ditari e shenuar ne rregjistrin tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- Diten e shenuar ne Vendimin e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per prishjen eshoqerise.
- Me hapjen e procedurave te falimentimit
- Ne raste te tjera te parashikuara ne ligj.

Neni 27

GJUHA

Ky statut dhe cdo dokument tjeter zyrtar paraqiten ne gjuhen shqipe.

Neni 28

BAZA LIGJORE

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, eshte kompetence e Asamblese se Ortakeve ose Ortakut te vetem, Qe te beje plotesimin e dispozitave te ketij statuti, si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave te cilat behen te pavleshme dhe jo efektive.

Ndryshimet do te behen me Vendim te Asamblese Ortakeve, ne perputhje te plote me dispozitat e legjislacionit shqiptar, dhe depozitohen ne QKB.

Ortaket Themelues:

Gianni Renzo Zoppellaro

Elton Xhani

Gianni Renzo Zoppellaro
Elton Xhani